

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

UNMIK RREG/2002/15  
26 korrik 2002

---

**RREGULLORE NR. 2002/15**

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS MBI  
METODOLOGJINË E CAKTIMIT TË LARTËSISË SË PENSIONIT BAZË NË  
KOSOVË DHE CAKTIMIN E DATËS PËR SIGURIMIN E PENSIONEVE BAZË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marr parasysh komunikatën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 8 korrik 2002 lidhur me ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 korrik 2002,

Me këtë shpall se ligji i miratuar në Kuvendin e Kosovës më 4 korrik 2002 hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2002/1).

Nënshkruar sot më 26 korrik 2002

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm



UNMIK

---

## INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE

### KUVENDI I KOSOVËS

#### Ligji nr. 2002/1

### Mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë

Kuvendi i Kosovës,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë atij me Rregulloren nr. 2001/9 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 të datës 22 dhjetor 2001 mbi pensionet në Kosovë,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë, e në veçanti nenin 4.2 mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensioneve bazë dhe nenin 32.1 për caktimin e fillimit të pagesës së pensioneve bazë,

Në përputhje me nenet 9.1.34-45 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme,

Me qëllim të vendosjes së metodologjisë për caktimin e lartësisë së pensioneve bazë dhe caktimin e datës për fillimin e pagimit të pensioneve bazë,

Me këtë miraton Ligjin vijues:

#### Neni I

#### DATA E FILLIMIT TË SIGUIRIMIT TË PENSIONEVE BAZË

Pensionet bazë do të fillojnë të paguhen që nga data 1 korrik 2002.

Personat që gëzojnë të drejtën e pensionit dhe të cilët paraqiten në Administratën Pensionale të Kosovës deri më 31 tetor 2002, do t'i marrin pensionet e tyre duke filluar nga data 1 korrik 2002.

Personat që kanë të drejtën e pensionit dhe të cilët paraqiten në Administratën Pensionale të Kosovës deri më 31 tetor 2002, do t'i marrin pensionet e tyre duke filluar nga muaji kur është bërë kërkesa.

## NENI II

### NORMA E PENSIONIT BAZË

Për vitin 2002 norma e pensionit bazë është 28 euro në muaj, ndërsa për vitet që pasojnë norma e pensionit bazë do të caktohet çdo vit në pajtim me paragrafët e mëposhtëm.

Pensionit bazë do të mbështetet në vlerën e kalorise minimale të shportës ushqimore siç është definuar në paragrafin III të mëposhtëm. Me qëllim të caktimit të një ndihme pensional bazë për vitin vijues, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do të përgatisë një vlerësim vjetor të shpenzimeve mesatare mujore në treg të shportës ushqimore me kalori minimale.

Shporta ushqimore me kalori minimale përfshin nevojat ditore prej 2.100 kalori në ditë për një person. Kjo përfshin artikujt ushqimorë dhe vlerat referuese të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe strukturat për konsumim të nevojave bazë në Kosovë, në konsultim me autoritetet tjera përkatëse të Kosovës.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave lypset që t'i garantojë Qeverisë së Kosovës jo më vonë se deri më 1 dhjetor të çdo viti se është ndarë një shumë e mjaftueshme në projekt-buxhet për vitin vijues për të paguar pensionet në nivelin e caktuar. Nëse Ministria nuk mund të garantojë se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për të paguar pensionet në shumën e dakorduar, Qeverisë i paraqet për miratim një propozim të arsyetuar për një shkallë të re buxhetore brenda kufizimeve buxhetore, i cili megjithatë nuk mund të jetë më i ulët se lartësia e vitit aktual. Shkalla e ndihmës pensionale nuk mund do të korrigohet gjatë vitit.

## NENI III

### AUTORITETI I MINISTRISË PËR EKONOMI DHE FINANCA DHE I MINISTRISË SË PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE

Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mund të lëshojnë vendime, udhëzime administrative dhe rregulla për çfarëdo çështjesh që kanë të bëjnë me funksionet që u atribuohen atyre sipas këtij ligji dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35.

## NENI IV

### HYRJA NË FUQI

Ky ligj hyn në fuqi më 26 korrik 2002.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm